

AGJËRIMI SHKAK I ISLAMIT TË TIJ

Agjërimi është një lidhje sekrete ndërmjet njeriut dhe Zotit, të cilën askush nuk mund ta sheh dhe as ta argumentojë - konfirmojë...Me këto dy gjëra besimtari arrin të artikulojë dy fuqi: fuqinë e vullnetit dhe mbikëqyrjes (besimit se Allahu di çdo gjë për ty) dhe këto dy fuqi janë pikërisht ato që na duhen më së shumti në çdo pore të jetës për të realizuar besimin e vërtetë...Kjo ngase njeriu bie në shirkun (idhujtarinë) e djallit dhe e pshihet në rastet kur mungon vullneti dhe mbikëqyrja, apo janë të dobëta. Mu për këtë Allahu na e ligjësoi këtë kurs trajnues për të përsosur mundësitë e ruajtjes së besimit tonë nga të ligat e e pshihet dhe djallit, e njëkohësisht na siguroi dhe ambient adekuat për suksesin e qëllimit të këtij adhurimi: dyert e Xhehennemit janë të mbyllura, dyert e Xhennetit janë të hapura, djajtë janë të lidhur me zinxhirë, ndërsa melaiket thërrasin: O kërkuesi i të mirës, eja! E kërkuesi i të keqes, mjaft më!, duke mos harruar këtu edhe shpërblimet tjera shpirtërore të cilat agjëruesi i arrin me rastin e iftarit (dhe bajramit) dhe me rastin e takimit me Allahun!

Rënkimi i heshtjes
Agjërimi shkak i Islamit të tij

Autobusi që duhej të na çonte nga hoteli në aeroport ia mbërriti. Mora valixhet e mia dhe i vendosa në të kurse vet zgjodha një ulëse pranë shoferit. Kohën sa prisnim pasagjerët tjerë e shfrytëzoja për të biseduar me të. E përshëndeta me: “Selamu alejkum!” kur ja ai ma ktheu: “Ue alejkumus selam ve rahmetullahi ve berekatuhu!”

U binda se ishte musliman edhe pse nga shenjat e fytyrës kuptohej një gjë e tillë.

Filluam të shkëmbejmë llafe në arabisht.

Desha që atë kohë të shkurtër ta shfrytëzoja me ca pyetje për mënyrën si e pranoi Islamin dhe si e mësoi arabishten. Më mahnti kur më tregoi se para katër vitesh e kishte pranuar Islamin. Atëbotë kishte jetuar në periferi të Parisit dhe kishte qenë në shoqëri me disa muslimanë. Një ditë kishte vërejtur se ata nuk hanin as nuk pinin. I kishte pyetur për këtë ndërsa përgjigja ishte: Jemi agjerueshëm! Deshi të njëhej më shumë me agjërimit por ata kishin pak njohuri për fenë...

U kthye në shtëpi ku gjeti murgeshën, e cila i vizitonte kohë pas kohe. Ia parapriu me pyetje rreth agjërimit në Krishterizëm. Pranoi se ka një lloj agjërimi. “Po Islami, a është feja e fundit që Zoti ia shpalli njerëzimit?”- e pyeti prapë. Përgjigja e murgeshës: “Po”, ishte një si një stuhi që trazoi ndjenjat e tij dhe jetën e tij e kanalizoi drejt Islamit. Atëherë lindi dëshira për ta mësuar Kur’anin dhe gjuhën arabe, kështu që lëshoi punën dhe shkoi në Siri ku u regjistrua në një institut gjuhe. Atje qëndroi për tri vite me radhë për tu kthyer më pas në Paris si besimtar musliman dhe njëherësh edhe thirrës – misionar i kësaj feje.

Pasi që e mbaroi tregimin e tij dhe koha e mbërritjes në aeroport veç u bë, unë e falënderova shumë për bisedën dhe për atë se mi hapi sytë për kuptimin e qëllimeve të agjërimit dhe meditimit të dispozitave të tij.

Ky tregim më ktheu për pesë vite në retrospektivë që të përkujtoj një tregim tjetër të një djaloshi francez që agjërimit qe shkak i pranimit të Islamit prej tij.

Ja, ne tash jemi në Ramazan, dhe si zakonisht, na shkon shumë shpejt. Ditët i ka të shpejta e netët të bukura por ndonjëherë shkon ashtu siç vjen. Mu për këtë e pyes veten time:

Përse agjërimi lëviz shpirtat që janë familjarizuar me kufirin (pabesimin) për dekada kurse shpirtat tanë jo?!

Here të tjera pyes:

Përse Allahu bëri që agjërimit të jetë shtylla e katërt e fesë edhe pse në këtë adhurim nuk ka asnjë kryerje riti apo obligimi me përjashtim të braktisjes së ushqimit,

pijes dhe dëfrimit seksual?...¹ Megjithatë, Allahu e bëri prej adhurimeve më të çmuara dhe me shpërblim më të madh saqë ka thënë:

إِلَّا الصَّوْمَ فَإِنَّهُ لِي وَأَنَا أَجْزِي بِهِ

...përveç agjërimit që është për Mua dhe Unë shpërblej për të!" Hadith kudsijj.

Nuk ka dyshim se urtësitë e agjërimit dhe mësimet e tij janë shumë më shumë se largimi nga ushqimi dhe marrëdhëniet seksuale. Ndryshe, agjërimit nuk do të ishte prej adhurimeve më të mëdha tek Allahu, (edhe pse në qëllime e jo në aspektin formal të kryerjes.) Mendoj se shkak i kësaj është se Ramazani është një kurs trajnues dhe përgatitor për të qenit stoik në rrugën e Allahut dhe për kryerjen e të obligimeve të të gjitha adhurimeve. Agjërimit sikur kursen besimtarin nga kjo (natyra e obligimeve tjera fetare) për ta forcuar atë për kryerje të adhurimeve tjera. Periudha njëmuajore e distancimit nga gjërat e sipërpërmendura njeriut i dhuron fuqi për rezistencë, durim, vetëpërmbytje, vullnet...

Agjërimit është një lidhje sekrete ndërmjet njeriut dhe Zotit, të cilën askush nuk mund ta sheh dhe as ta argumentojë - konfirmojë...Me këto dy gjëra besimtari arrin të artikulojë dy fuqi: fuqinë e vullnetit dhe mbikëqyrjes (besimit se Allahu di çdo gjë për ty) dhe këto dy fuqi janë pikërisht ato që na duhen më së shumti në çdo pore të jetës për të realizuar besimin e vërtetë...Kjo ngase njeriu bie në shirkun (idhujtarinë) e djallit dhe epshit në rastet kur mungon vullneti dhe mbikëqyrja, apo janë të dobëta. Mu për këtë Allahu na e ligjësoi këtë kurs trajnues për të përsosur mundësitë e ruajtjes së besimit tonë nga të ligat e epshit dhe djallit, e njëkohësisht na siguroi dhe ambient adekuat për suksesin e qëllimit të këtij adhurimi: dyert e Xhehennemit janë të mbyllura, dyert e Xhennetit janë të hapura, djajtë janë të lidhur me zinxhirë, ndërsa melaiket thërrasin: O kërkuesi i të mirës, eja! E kërkuesi i të keqes, mjaft më!, duke mos harruar këtu edhe shpërblimet tjera shpirtërore të cilat agjëruesi i arrin me rastin e iftarit (dhe bajramit) dhe me rastin e takimit me Allahun!

Mu për këtë, Allahu ka thënë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا كُتِبَ عَلَيْكُمُ الصِّيَامُ كَمَا كُتِبَ عَلَى الَّذِينَ مِن قَبْلِكُمْ لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ

O ju që besuat, agjërimit u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm." El-Bekare, 183.

Nuk mendoj se realizohet dot devotshmëria pa vullnet të fortë për kryerje të veprave të mira dhe largimit nga e keqja, e po kështu edhe me fuqi të besimit se Allahut na sheh dhe di për ne çdo gjë që bëjmë e veprojmë kurdo dhe kudo që jemi.

Prej aspektit madhështor të legjisacionit islam është edhe fakti se në Ramazan janë obliguar Zekati dhe Xhahadi. Kjo ngase për dhënie të pasurisë që është e shtrenjtë për njeriun dhe për dhënie të jetës në rrugën e Allahut duhet një forcë dhe fuqi e madhe vullneti dhe besimi se Allahun e ke me vete çdoherë.

Këto ishin vetëm disa nga dhuratat dhe mirësitë e agjërimit, për të cilin e lus Allahun të na shpërblejë!

Dr. Musfir b. Alijj el Kahtani

<http://www.twbh.com/index.php/site/article/readyad7ol-aleslam>

Përshtati në shqip: Sedat ISLAMI

22-8-2010

¹ Këtu, në vend të këtyre tri pikave është kjo pjesë e tekstit në vijim, të cilën e shkoqa në fusnotë që të mos keqkuptohej nga disa lexues të rëndomtë meqë bëhet fjalë për një elaborim nga këndvështrimi i Shkencës së Usuli Fikhut. Ja teksti që duhej të ishte më sipër: "...Agjërimit nuk është si namazi që kryhet çdo ditë me kushte dhe përshkrim të caktuar. As si Zekati që ndahet nga pasuria, dhe as si Haxhi që ka një mori ritesh në vete. Braktisja e ushqimit dhe dëfrimit është vepër, sipas usulistëve, por vështruar nga prizmi konkret (lëndor – material) i dispozitave, kjo nuk arrin gradën e performancës (el edae الأداء) kryerja e asaj që është obligim në kohën e caktuar fetarisht)..."